



DESTINIMI: HIDROSTOP HS është emulsion special përmblyllës akrilik për mure, çati të sheshta, bodrume dhe çfarëdo lloj tjetër sipërfaqesh betoni. **HIDROSTOP HS** është hidroizolim i shkëlqyer. Me një aplikim shumë të thjeshtë fitohet hiroizolim i shkëlqyer.

Filmi i fituar me **HIDROSTOP HS** është shumë elastik, i qendrueshëm, rezistent ndaj ujit dhe dekorues në të njëjtën kohë.

HIDROSTOP HS është prodhim ideal për sipërfaqe me plasaritje sepse është shumë elastik.

APLIKIMI: HIDROSTOP HS mund të përdoret brenda dhe jashtë, në sipërfaqe të vjetra dhe të reja. **HIDROSTOP HS** mund të përdoret mbi llaç, tulla, beton, gips dhe dru.

Përdorimi kryesor është si hidroizolim për çati të sheshta, ballkone, bodrume, themele, banjo, pishina, shatërvanë etj.

Veçori: Filmi rezistent ndaj ujit që **HIDROSTOP HS** e formon plotësisht rezistent ndaj ujërave të shiut, deri edhe pas një periudhe shumë të gjatë të qëndrimit të të njëjtave mbi të. Filmi nga **HIDROSTOP HS** është shumë elastik kështu që ai mund të mbulojë plasaritje, por gjithashtu është rezistent edhe ndaj krijimit të plasaritjeve të reja të sipërfaqeve tashmë të mbuluara prej tij. **HIDROSTOP HS** ka ngjitje në sipërfaqe të ndryshme (beton, llaç, dru etj.) **HIDROSTOP HS** paraqet veçori të shkëlqyera ndaj ndikimeve të kohës në periudhë më të gjatë. Sipërfaqet e lyera me **HIDROSTOP HS** janë të sheshta, pa bashkime dhe fuga. **HIDROSTOP HS** mund të pigmentohet në çfarëdo lloj nuance.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE:

Pamja	emulsion i dendur elastik akrilik me bazë ujore
Nuanca	ngjyra themelore e bardhë ose me çfardo lloj ngjyre tjetër
Pesha specifike (20 c)	përafërsisht 1,15 gr/cm ³
Vlera pH	8 - 9
Virulencë	nuk është helmues
Temperatura e ruajtjes dhe punës	5 - 35 C

PËRGATITJA E SHTRESËS: shtresa që duhet të lyhet me **HIDROSTOP HS** duhet të jetë e pastër dhe e shëndetshme (pa pluhur, pa pjesë të lëvizshme dhe e payndyrshme) dhe detyrimisht e thatë. Është e rekomandueshme larje të mirë të sipërfaqeve një ditë para fillimit me punë.

Rekomandohet përdorim të **PRAJMER HS** si lidhje midis sipërfaqes dhe **HIDROSTOP HS**. Mundet si alternativë e **PRAJMER HS** të bëhet shtresë me **HIDROSTOP HS** dhe ujë në raport 1 : 1 si dorë e parë.

Përdorimi: **HIDROSTOP HS** mund të hollohet me ujë për aplikim më të mirë maksimumi deri 15%. Zakonisht aplikohen dy deri tre duar. **HIDROSTOP HS** aplikohet në sipërfaqet me rul (në shtresë plotësisht të thatë). Përdorim të fuqës vetëm në vendet ku nuk mundet me rul. Çdo dorë tjetër aplikohet pas tharjes së dorës paraprake. Temperatura gjatë kohë së punës nuk duhet të jetë nën 5C dhe nuk rekomandohet të punohet në temperatura mbi 35C.

MBROJTJE GJATË PUNËS: Gjatë punës duhet të përdoren mjete personale për mbrojtje.

KONSUMI: Në varësi të destinimit konsumi lëviz nga 0,5 kg/m² deri 1,5 kg/m². Për sipërfaqe vertikale është e mjaftueshme nga 0,5 kg/m² deri 0,8 kg/m². Për hidroizolim të mirë të jashtëm horizontal janë të mjaftueshme 1 kg/m² deri 1,2 kg/m². Mund të përforcohet me rrjetëz qelqi.

AFATI I SKADIMIT: Një vit në ambalazhin origjinal.

RUAJTJA: Të ruhet e mbyllur në ambalazhin origjinal, në hapësira me temperaturë midis 5C dhe 40C. Nuk është e rekomandueshme që ruhet kohë më të gjatë nën ndikimin e diellit.